



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
NJËSIA BAZË REGJI,REGJI FILMI & TV

VENDIM

i Komisionit Ad Hoc të Vlerësimit të Kandidatëve (KVK), për vendin e 1 (një) punonjës mësimor (LEKTOR/AS.LEKTOR) për lëndën: “PLASTIKË”(LËVIZJE SKENIKE, BETEJË SKENIKE DHE PANTONIMË) DHE MJESHTRI AKTORI, Fakulteti i Artit Skenik

Sot më datë 06/06/2022 ora 10:00 Komisioni Ad Hoc i vlerësimit të kandidaturave që konkurrojnë për punonjës mësimorë nga kategoria (Lektor/As.Lektor) në lëndën **PLASTIKË”(LËVIZJE SKENIKE, BETEJË SKENIKE DHE PANTONIMË) DHE MJESHTRI AKTORI**, në programin e studimit REGJI, ngritur me Urdhërin e Dekanit të FAS Nr.7/02.06.2022, pasi shqyrtoi fazat e konkurrimit mbështetur në Urdhërin nr. 40/31.05.2022 të Rektorit të Uart Prof. Kastriot ÇAUSHI, si dhe kriteret e Njesisë Bazë Regji,Regji Filmi & TV, vendosur për këtë qëllim, Komisioni Ad -Hoc në vlerësim unanimit,

VENDOSI

Renditjen përfundimtare sipas pikëve në të dyja fazat :

- 1. REDJAN MULLA** - 93.75 pikë.
- 2. EGLANTINA CENOMERI/BUDINA** - 56.02 pikë

Komisioni Ad Hoc i Vlerësimit të Kandidatëve



**KONKURSI I KONKURIMIT,
PËR PUNONJËS MËSIMORË “LEKTOR/ASISTENT LEKTOR” NË
LËNDËN “PLASTIKË (LËVIZJE SKENIK, BETEJË SKENIKE DHE
PANTONIMË), NË PROGRAMIN E STUDIMIT REGJI
NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK**

➤ **KLASA E AKTRIMIT DITËN E MERKURE**

DATË 06/06/2022 ORA 10:00



V/R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANI

URDHËR

Nr. 7, Datë 06/06/2022

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
KANDIDATURAVE QË KONKUROJNË PËR PUNONJËS MËSIMORË,
AS/LEKTORË/ LEKTORË NË PROGRAMIN E STËDIMIT REGJI, LËNDA
“PLASTIKË” (LËVIZJE SKENIKE, BETEJË SKENIKE DHE PANTOMIMË) NË
FAKULTETIN E ARTIT SKENIK**

Mbështetur në nenin 64 (Punësimi i personelit akademik) të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nenin 40 (Funksionet e Dekanit) dhe nenin 56 (Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë) të Statutit të UART, Urdhërin nr. 40, datë 31/05/2022 të Rektorit të UART “Mbi procedurat e konkurimit për punonjës mësimorë, as/lektorë/lektor në programin e studimit “Regji” lënda “Plastikë (Lëvizje skenike ; Betejë Skenike dhe Pantomimë) në Fakultetin e Artit Skenik në UART,

urdhëroj

1. Ngritjen e Komisionit ad-hoc për vlerësimin e kandidatave që konkurojnë për punonjës mësimorë, as/lektorë/ lektorë në programin e studimit Regji në lëndën “Plastikë (Lëvizje skenike; Betejë Skenike dhe Pantomimë) si më poshtë :
 - Prof.asoc.Alert ÇELOALIAJ KRYETAR Shef departamenti Regji, RFTV
 - Prof.Miltiadh KUTALI ANËTAR Departamenti Regji, RFTV
 - Prof.asoc. Genci FUGA ANËTAR Departamenti Regji, RFTV
 - Doc. Arben SPAHIU ANËTAR Departamenti Aktrim dhe Teori
 - Msc. Elia PLAKU ANËTAR vendosur me urdhër të Rektorit të UART (Drejtor-Burimet Njerëzore)
2. Komisioni ad-hoc organizon, drejton dhe mbikqyr procedurat e zhvillimit të konkurimit, shqyrton dosjet dhe vlerëson me pikë kandidaturat e paraqitura mbi bazën e kriterëve të propozuara nga departamenti dhe miratuar nga Rektori.
3. Komisioni kryen me përgjegjësi gjithë procedurat e vendosura për këtë qëllim në urdhërin e Rektorit nr.40, datë 31/05/2022.
4. Procedurat e konkurimit të organizohen më datë **06/06/2022 ora 10.00** në zyrën e Departamentit Regji, Regji Filmi dhe TV.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. Me përfundimin e gjithë procedurave i gjithë dokumentacioni të paraqitet në zyrën e dekanit të FAS për t'ja dërguar për procedurë të mëtejshme Rektorit të UART.
6. Ky urdhër t'ju bëhet më dije për zbatim anëtarëve të komisionit. Po ashtu kopje të këtij urdhëri i dërgohet Rektorit të UART dhe Drejtorisë së Burimeve Njërëzore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Petrit MALAJ

DEKAN

FAKULTETI I ARTIT SKENIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE



Nr.650/3 prot.

Tiranë, më 31/05/2022

URDHËR

Nr. 90 , Datë 31/05/2022

**MBI PROCEDURAT E KONKURIMIT, PËR PUNONJËS MËSIMORË “ ASISTENT
LEKTOR/LEKTOR” NË PROGRAMIN E STUDIMIT REGJI LËNDA PLASTIKË
(LËVIZJE SKENIKE;BETEJË SKENIKE DHE PANTONIMË) DHE MJESHTRI AKTORI
NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Arteve, Shkresën e Rektoratit Nr. 650/2 prot.,datë 14/04/2022, shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 50 datë, 19/04/2022, për konkursin në pozicionin As.Lektor/Lektor në FAS, duke patur në konsideratë faktin se marrja në punë e personelit akademik në institucionet e AL kryhet me konkurim publik, mbi bazën e shpalljes së vendeve të lira dhe përcaktimit të kriteve për çdo vend pune, plotësimi i të cilave përbën kushtin themelor për konkurimin e kandidatëve dhe punësimin e tyre si punonjës mësimor, vlerësimi i dosjeve të kandidatëve konkurrues do të kryhen nga Komisioni Ad Hoc i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), ngritur posaçërisht për këtë qëllim,

URDHËROJ:

1. Komisioni Ad-Hoc i vlerësimit të kandidaturave që konkurrojnë për punonjës mësimorë në Fakultetin e Artit Skenik, për pozicionin e punës “Asistent Lektor”/”Lektor”, në Programin e Studimit Regji, Lënda Plastikë(lëvizje skenike, betejë skenike dhe pantonimë) dhe Mjeshtri Aktori, ngrihet me Urdhër të Dekanit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë;
2. Për ngritjen e komisionit, Dekani vepron në këtë mënyrë:
 - a. Përzgjedh ndër personelin akademik 2 (dy) anëtarë,
 - b. Njësia Bazë përzgjedh ndër personelin akademik 2 (dy) anëtarë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE



- c. Emëron për anëtarë Komisioni, për konkursin e shpallur në, Buletinin e Njoftimeve Publike, për pozicionin “Asistent lektor”/”Lektor”, në FAS, 1 (një) anëtarë përfaqësues të Rektoratit, (Dr. Menaxhimit të Burimeve Njerëzore), të caktuar nga Rektori.
3. Komisioni ad hoc organizon, drejton dhe mbikqyr procedurat e zhvillimit të konkurrimit, shqyrton dosjet dhe vleron me pikë kandidaturat e paraqitura mbi bazën e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për këtë specialitet të publikuara dhe të shpallura publikisht nga Rektorati i Universitetit të Arteve. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit ad hoc janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit, duke filluar që nga marrja në dorëzim e dosjeve të kandidaturave, zhvillimin e konkurrimit deri në shpalljen e vendimit për vlerësimin, renditjen dhe përzgjedhjen e kandidaturave;
 4. Komisioni ad hoc, duhet të përfundojë procedurat e konkurrimit të përcaktuar në urdhër, brenda 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhëri;
 5. Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ndihmon Komisionin ad hoc, mbikqyr dhe kontrollon zhvillimin e procedurave të konkurrimit në përputhje me aktet e zbatueshme, si dhe njofton periodikisht Rektorin, për ecurinë e tyre. Në rastet kur vërehen shkelje, Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore njofton menjëherë Rektorin, i cili mund të vendosë pezullimin e procedurave. Në përfundim të konkurrimit, DMBNJ i paraqet Rektorit një raport me shkrim mbi zhvillimin e procedurave të konkurrimit;
 6. Çdo anëtarë i Komisioni ad hoc është i detyruar të shqyrtojë në mënyrë individuale të gjitha dosjet e prezantuara për konkurrim. Komisioni ad hoc bën vlerësimin e dosjeve duke përcaktuar pikët e fituara për çdo dosje;
 7. Menjëherë pas përfundimit të vlerësimit të fazave të konkurrimit, Komisioni ad hoc bën mbledhjen e pikëve të fituara për secilin kandidat si dhe përcakton renditjen përfundimtare të kandidatëve sipas pikëve të fituara. Komisioni ad hoc, bën klasifikimin e konkurrentëve, të cilët kanë marrë mbi 60% të pikëve totale (vendosur nga Komisioni ad hoc). Kandidatët me më pak se 60% të pikëve konsiderohen të skualifikuar;
 8. Vendimet e Komisionit ad hoc merren me shumicë votash. Anëtarët nuk lejohet të abstenojnë;
 9. Renditja përfundimtare e kandidatëve shpallet publikisht nga Komisioni ad hoc;

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE



10. Dekani i Fakultetit i paraqet Rektorit listën e kandidatëve sipas renditjes së pikëve të fituara. Rektori lidh Kontratën e Punës me kandidatin e përzgjedhur;
11. Kandidatët mund të ankohen tek Rektori për vlerësimin e pikëve shpallur nga Komisioni ad hoc, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e kesaj liste. Në këtë rast si dhe në rastet kur Rektori e çmon të nevojshëm verifikimin e procedurave të konkurrimit, dosja e plotë e konkursit i paraqitet menjëherë Rektorit nga Dekani i Fakultetit.
12. Në rastet e përcaktuara më lart, Rektori shqyrton dosjen e konkurimit dhe vendos sipas rastit:
 - a. Të mos pranojë ankimin;
 - b. Të kthejë dosjen e konkursit për rivlerësim;
 - c. Të anulojë konkursin.
13. Ngakohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Dekani dhe Komisioni ad hoc, për zbatimin e këtij urdhëri. Ky urdhër shpallet në mjediset e Fakultetit dhe u bëhet i njohur kandidatëve para fillimit të konkursit;
14. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot ÇAUSHI



REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE